



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Beledijesi  
Kryetari i Komunës \* Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 153/26 Dt. 02.04.2026



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Administratës, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Administratës për lejimin e realizimit të projektit: “Angazhimi i ekspertit individual për hartimin e rregullores për organizimin e brendshëm, sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Komunën e Prizrenit dhe statutin e QKMF-së në Komunën e Prizrenit”, kështu që, për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit për mbledhjen e ofertave përkatëse.
2. Ky projekt realizohet sipas kodit të planifikuar buxhetor të Drejtorisë së Administratës – pozicioni mallra e shërbime.
3. Obligohet Drejtoria e Administratës, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Administratës,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Sektorit të Prokurimit,
  - Arkivës së Kryetarit.